



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Pranuar - Prilapje dëftoza			
30.06.2020			
Nr./ organit Org. broj	Numri/Oraj	Çatësia Prilapje	Vlera Vrednos*
01-110/05	544		

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2 pika d), dhe neni 40, paragrafi 40.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 35 paragrafi 35.2 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.06.2020, merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021

Neni 1

Me këtë Vendim, Kuvendi Komunal i Vitisë MIRATON vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetori të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2020.

Komisioni për bëhet nga këta anëtar:

1. Naim Pira Kryesuesi i Kuvendit Komunal
2. Xhilsime Qamili Përfaqësuese nga GP- të LDK-së
3. _____ Përfaqësuese nga Shefi i GP- të VV-së
4. Avdi Rexhepi Përfaqësues nga GP- të PDK-së
5. Valentina Hasani Përfaqësuese nga GP-të AAK-së
6. Fatlum Demiri Sekretaria e Kuvendit
7. Tefik Salihu Përfaqësues nga shoqëria civile

Neni 2

Grupi punues konform neni 1 të këtij vendimi, në konsultim me kryetarin e Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe shoqërinë civile, harton Draftin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin kalendarik 2020 dhe të njëjtin e paraqet para Kuvendit të Komunës për miratim.

Neni 3

Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbajë: objektivat dhe qëllimet e kuvendit, aktivitetet e planifikuara të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe funksionale të Kuvendit, afatet e përbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara si dhe koston financiare për implementimin e Planit të punës.

Neni 4

Plani i punës së Kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e Kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 të Rregullores (QRK) Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, neni 16 i Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Dorëzohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit
2. Anëtarëve të grupit punues, dhe
3. Arkivit.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

